



Pranuar / Dorezuar Prilbena/Prodato Received/Delivered	01.12.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinita Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSHICK	7196/2023		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1314/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shaban, anëtarë; me Ardita Percuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, si procesmbajtëse, sipas ankesës me numër A.nr.1314/2023, të datës 23.10.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3; nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.12.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

**Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.1314/2023, e datës 23.10.2023, e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Nëpunësi civil, (tutje vetëm ankuesi), i punësuar në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale në kuader të Ministrisë së Shëndetësisë, më datë 23.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor lidhur me klasifikimin jo të drejtë sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, ndërsa, kjo e fundit, më datë 27.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e parakohshme, sepse:



Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi është i punësuar në Agjencinë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe se i njëjti sipas Akt të Emërimit me Nr.Prot.135 të datës 01.02.2012, ushtron pozitën e punës “Udhëheqës i Sektorit Mikrobiologji Mikrobiologji/Biologji”, në Departamentin-Laboratori Zyrtar i Kontrollit të Kualitetit të Produkteve Medicinale/LZKKPM.

Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi ka realizuar koeficient nëntë (9) të pagës-sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesi është klasifikuar në kategorinë Drejtues i Ulët, duke realizuar koeficient IL10-7.35/771.75 euro.

Ankuesi, me datë 23.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se ka kualifikim si doktor i mjekësisë, e pastaj specialist i mikrobiologjisë klinike, ndërsa i njëjti e pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, është kategorizuar në Kategorinë Drejtues i Ulët, me koeficient të pagës shtatë pikë tridhjetë e pesë (7.35) euro, duke e vlerësuar si klasifikim të pa drejtë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafin 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj''*, dhe nenin 14, paragrafin 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (i aplikueshëm në këtë periudhë) dhe Rregullores(QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por, si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve, të përcaktuar me Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16.02.2023 dhe Vendimit Nr.17/162 të datës 27.09.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim





me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankueses për kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë e specialistit të mikrobiologjisë me koeficient 12 tw pagës, është e parakohshme dhe si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor. Rrjedhimisht, e njëjta, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lartë, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që, mbështetur në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1314/2023

Ardita Perçuku SHYTI

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhiukaj DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

